

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: GJUHË SHQIPE



PËRDORIMI I MËNYRËS HABITORE NË ROMANET E KADARESË

PUNIM DIPLOME

Mentorja:

Dr. Rovena Vata

Studenti:

Mark Mataj

Gjakovë, 2017

UNIVERSITETI I GJAKOVËS

“FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

PËRDORIMI I MËNYRËS HABITORE NË ROMANET E KADARESË

Komisioni:

Kryetar Kamber Kamberi

Anëtar Rovena Vata

Anëtar Emin Kabashi

Mentorja:

Dr. Rovena Vata

Studenti:

Mark Mataj

Gjakovë, 2017

## PASQYRA E LËNDËS:

HYRJE.....	4
KREU I: Figura e Ismail Kadaresë në letërsinë shqiptare.....	6
1.1 Ismail Kadare personalitet i letërsisë dhe kulturës shqiptare.....	6
1.2 Pasuria gjuhësore e romaneve të Ismail Kadaresë.....	7
KREU II: Shtresa letrare si veçanti sintaksore.....	10
2.1 Struktura sintaksore si shtresë letrare.....	10
2.2 Veçantitë sintaksore përbëjnë vlerë letrare.....	10
KREU III: Mënyra habitore në shtrirje letrare.....	19
3.1 Mënyra habitore në veprën artistike të Ismail Kadaresë.....	19
3.2 Përdorimi i mënyrës habitore në tri romanet e Ismail Kadaresë.....	20
KREU IV: Analizë e mënyrës habitore në romanet e Ismail Kadaresë.....	22
KREU V.....	27
Përfundime.....	27
Bibliografia.....	29

## HYRJE

### 1. Objekti dhe motivimi i temës

Në gjuhësinë shqiptare nuk mungojnë studimet, të cilat bëjnë fjalë mbi shumë çështje të gramatikës. Përsa i përket mënyrës habitore dhe sidomos studimit të saj në veprat e Ismail Kadaresë është objekti i studimit të kësaj teme.

sidomos mbi veprat letrare të letërsisë së sotme bashkëkohore shqiptare.

Me sugjerimet e mentores sime Dr. Rovena Vata dhe me dëshirën që kam pasur këto katër vite për të studiuar një autor të letërsisë së sotme bashkëkohore shqiptare, sic është edhe emri i Ismail Kadaresë. Si bazë kryesore e kësaj teme janë tri romane të Ismail Kadaresë, ku kam për synim, që të hetojmë përdorimin e kësaj mënyre me të gjitha format foljore të saj.

Dimë që një vepër letrare, padyshim është ndërtuar falë mjeteve gjuhësore, të cilat i japin ngjyra dhe trahjta veprës letrare. Këto mjete gjuhësore shkrimtari arrin t'i përdorë me anë të figurave të ndryshme stilistike, ku i ndërton përmes ndihmës së trajtave foljore dhe të kategorive të tjera gjuhësore. Te ky shkrimtar mënyra habitore gjen një përdorim të ngjeshur, pothuajse të gjitha format e saj, duke shprehur emocione dhe ndjenja të ndryshme. Duke marrë në analizë mënyrën habitore të Ismail Kadare jemi ndalur në tri romanet e tij, të cilët kanë më së shumti përdorim të shpeshtë si romanet: *Gjenerali i ushtrisë së vdekurt*, *Prilli i thyer* dhe *Çështje të marrëzisë*.

### 2. Metodologjia dhe metodat e punës

Ky studim kemi menduar që ta ndërtojmë mbi bazën e ilustrimeve dhe të analizës me pjesë nga teksti i romaneve të sipërpërmendura më sipër. Gjatë studimit për këtë temë kemi përdorur metodën e krahasimit dhe atë të analizës.

### **3. Baza teorike e punimit**

Për ta realizuar këtë studim u mbështetëm në një literaturë të pasur gjuhësore, por edhe letrare, për të marrë një informacion teorik lidhur me temën e punimit, sepse përdori e i trajtave foljore të habitores, në gjuhën shqipe ka një specifikë të veçantë. Ky studim do të ndërtohet në bazë të ilustrimeve dhe të analizës me pjesë nga teksti i romaneve të përmëna më sipër.

### **4. Synimi i temës**

Analiza e veprave në këtë formë që kemi zgjedhur ne, ka rëndësi të veçantë për thellimin e njohjes së veçorive fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksiko-frazeologjike në tri romanet e zgjedhura të Kadaresë. Mbështetur mbi traditën e studimeve më të hershme, por edhe të sotme të fushës së morfologjisë dhe sintaksës do të ndalemi në veçoritë morfologjike, sintaksore, si dhe në vlerën e stilit, që e karakterizojnë penën e Kadaresë në përdorimin e dendur të mënyrës habitore.

## KREU I: Figura e Ismail Kadaresë në letërsinë shqiptare

### 1.1 Ismail Kadare personalitet i letërsisë dhe kulturës shqiptare

Ismail Kadare është personalitet i jetës kulturore dhe letrare në Shqipëri dhe jo vetëm. Personaliteti dhe vepra e Kadaresë kanë luajtur rolin e një shkolle në zhvillimin dhe ripërtëritjen e letërsisë shqipe; ato kanë ushtruar një ndikim aq të madh dhe kanë pasur një forcë aq të madhe, sa që pa to nuk mund të kuptohet i gjithë procesi i risimit dhe i emancipimit të kulturës shqiptare, në rrjedhë të kohëve moderne të saj, do të shprehej Jorgo Bulo<sup>1</sup>.

Tregimin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*<sup>2</sup>, në formën e romanit, Ismail Kadare e ka botuar në vitin 1963<sup>3</sup>. Vetë titulli i këtij romani ka të bëjë më një ushtri e cila e gjitha është e vdekur.

Romani *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* famën e tij deri në Francë, ku pati një sukses të përnjëhershëm. Ismail Kadare në këtë roman, ngre lart qëndresën shqiptare kundër fashizmit italian, duke dhënë njëkohësisht tërë magjinë e një vendi malor, të humbur në mjegullën përtej Adriatikut, enigmën e të cilit nuk mundi ta kuptojë kurrë asnjë pushtues<sup>4</sup>.

Roman ky që të habit, i pajisur me një lloj fuqie magjepsëse që vjen njëherit nga subjekti rrënqethës, por të trajtuar në mënyrë shumë të gjerë dhe nga ironia therëse, e hapët dhe shpesh tejet e pikëllueshme, që shpreh hidhësinë e tij. *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* doli për herë të parë në bullgarisht 1966, në serbisht 1968 dhe në turqisht 1968-1969.

Rëndësia dhe përmasa e vërtetë e rolit emancipues dhe reformator të veprës së Kadaresë në kulturën shqiptare bëhet më i qartë po të kemi parasysh faktin se zhvillimin letrar në Shqipërinë e kohës e mundonin kufizimet e imponuara prej kontekstit politik-ideologjik, prej një modeli kulturor komod për orientimin zyrtar të jetës artistike dhe shpirtërore të asaj shoqërie e pa dyshim edhe forca e intercisë së traditave artistike anakronike<sup>5</sup>.

---

<sup>1</sup> Jorgo Bulo, *Kadareja dhe letërsia shqipe*, në: "Studime filologjike", nr. 1-2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006, f. 5.

<sup>2</sup> Ismail Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, tregim botuar në revistën "Nëndori", nr. 5, maj 1962, f. 53-76.

<sup>3</sup> Ismail Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, roman, Naim Frashëri, Tiranë, 1963.

<sup>4</sup> Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, Onufri, Tiranë, 2000, f. 184.

<sup>5</sup> Jorgo Bulo, *Kadareja dhe letërsia shqipe*, në: "Studime filologjike", nr. 1-2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006, f. 5.

Kadare në rrëfimin e tij në të tre romanet i rrëfëhet lexuesit të tij gjatë gjithë kohës. Të treguarit ose narracioni ka të bëjë me procesin e parashtrimit të një vijimësie ngjarjesh. Të treguarit në disiplinën narratologjike dallon nga të treguarit e tjerë, pasi në rastin e narratologjisë kemi një vijimësi të ngjarjeve.

Romani *Prilli i thyer* ka në qendër të trajtimit të tij pikërisht Kanunin e Lekë Dukagjinit. Interesimi i Ismail Kadaresë për për Kanunin është i hershëm, por romani *Prilli i thyer* paraqet kulmin e këtij interesimi.

Në poetikën e romanit të Kadaresë vepron logjika e bashkimit zinxhir, sipas së cilës çdo fjalë, çdo veprim e çdo mendim luan rolin e vet në mekanizmin e formësimit të figurës-personazh. Kjo e fundit, duke u shfaqur si një sistem mjetesh ligjërimore, që kanë hyrë në rapote të veçanta midis tyre, është në të vërtetë sistemi i të menduarit artistik të Kadaresë. Si në çdo vepër të tij, edhe të ky roman, Kadareja krijon një sistem të ri, mjaft të pasur të mekanizmit të ndërtimit të figurës<sup>6</sup>.

## 1.2 Pasuria gjuhësore e romaneve të Ismail Kadaresë

Vepra letrare e Kadaresë dallohet për larmishmërinë e figurshmërisë gjuhësore, ku shprehej e gjithë ajo pasuri që gjejmë në romanet e Kadaresë. Që të arrijmë të bëjmë studimin e gjuhës dhe të stilit të Ismail Kadaresë, na duhej të mbështetemi në parimet si dhe në metodat që na ofron stilistika gjuhësore sot, pasi nëse nuk do kishim praninë e saj, nuk do mund të arrijmë të bëjmë një analizë të plotë sic e kemi parashikuar.

Xhevat Lloshi në *Stilistikën e tij* thotë se “gjuha është një visar, një repertor mundësish”<sup>7</sup>.

Në aspektin morfologjik përgjatë studimit kemi gjetur veçori si për zhanrin si për stilin e Ismail Kadaresë, në mënyrë të veçantë folja i jep ngjyrë gjithë tekstit të tij artistik.

Pasuria gjuhësore e romaneve të Kadaresë dallohet në vecanti për potencialin stilistik të foljes. Asnjëra prej fjalëve të gjuhës nuk e ka bazën semantike, aq të gjerë e sistemin e formave gramatikore, aq të pasur e të degëzuar sa folja. Folja është njëra ndër kategoritë gjuhësore më të zgjeruara e më të ndërlikuara, prandaj paraqet pjesë përbërëse të çdo dukurie leksikore.

---

<sup>6</sup> Floresha Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006, f. 146.

<sup>7</sup> Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999, f. 75.

Si vlerë gjuhësore në veprat e Kadaresë gjatë studimit tonë na doli edhe fjalëformimi, si një vlerë e konsiderueshme në fushën e gjuhësisë shqiptare, dhënë përmes mjeteve dhe figurave letrare.

Kjo, sepse është pikërisht fjalëformimi një tipar dhe vlerë gjuhësore, i cili shërben mjaft mirë për të kuptuar edhe një pjesë të stilit të shkrimtarit nga aspekti gjuhësor apo ai kuptimor. Mënyra sesi e përdor Kadare fjalën, ngjyrimet kuptimore apo gjuhësore, por edhe leksikore dhe ngarkesat emocionale, përbëjnë në roman një vlerë me vete.

Me bindje mund të themi se Ismail Kadare nuk i ka borxh fjalës, por fjalori i gjuhës shqipe të sotme i ka borxh Kadaresë, sepse ndihmesa e tij qëndron në aspektin semantik të fjalëve. Leksiku i tij sjell përfitime, jo vetëm në pasurinë që ka, por edhe në hijeshinë, që i jep fjalës me ngjyrimet e dukura.

Kadare i ka sjellë gjuhës shqipe fjalë të dobishme në jetën praktike, me kuptime dhe brendi të thella filozofike edhe në aspektin e drejtpërdrejtë edhe në fushën e tropeve figurative. Kadare nuk i është ndarë asnjëherë habitores dhe urdhërores së shqipes që ka ndjekur që herët për krijimin e fjalëve të reja duke u mbështetur në parimet që vetë gjuha ndjek.

Kadare i sjell freski gjuhësore fjalëve, begati, me fjalë të reja, të zgjedhura, të qëlluara, të fuqishme nga ana kuptimore dhe me lidhje të reja e të bollëshme fjalësh në trull të lakimit dhe të zgjedhimit. Të gjitha këto që thamë më lart duan të vërtetohen. Prandaj duke i marrë një nga një paragrafët dalin qartë edhe rëndësia apo vlerat e këtyre fjalëformimeve.

Kështu po t'i referohem këtij romani të Kadaresë, në paragrafët e tij shohim se duket qartë që raporti i tij me fjalën është i ngushtë, sepse fjalëformimet e përdorura prej tij dhe të nxjerra prej tij bëhen produkt i fjalorit të fjalive në përdorim të çdo kujt prej nesh apo ndryshe siç quhet ndryshe fondi gjuhësor komëbtar, sepse fjalëformimet e tij janë fjali që mbështeten fort tek gjuha standarde kombëtare, pra s'ka fjali të cilat mund të përdoren nga një rreth i ngushtë. Pra, rrethi i përdorimit të tyre është i gjerë.

Ismail Kadare krijon duke u mbështetur mbi bazat e gjuhës standarde të sotme, duke treguar kujdes dhe pasion të lartë, sepse është i ndërgjegjshëm për rolin dhe parimet e saj, për rëndësinë dhe vlerën që ka. Rëndësia dhe vlera e këtyre fjalëve fjalëformuese dhe një pjesë e tyre në fokusin e neologjizmave është e madhe sepse:

1. Duke krijuar fjalë të reja u jep atyre ngjyrimet kuptimore, sipas kontekstit që i përdor në roman,



2. I jep shton një pasuri më shumë, si leksikut në veçanti, por edhe gjuhës shqipe në përgjithësi,
3. Përveç se një vlerë e shtuar, por edhe shërbën si një mjet i rëndësishëm për të bërë të mundur shmangien e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, gjë e cila po ndodh çdo ditë e më shumë, kjo falë teknologjisë në ditët e sotme,
4. Këto fjalë përbëjnë një urë lidhëse në të gjithë hapësirën shqiptare, kudo ku flitet shqipe, brenda dhe jashtë kufijve të saj,
5. Jepet i njëjti burim gjuhësor, por me ngjyresa të reja, qofshin ato artistike apo stilistike, duke i shtuar një vlerë pasurisë së fushës semantike dhe jo vetëm.

## KREU II: Shtresa letrare-veçori sintaksore

### 2.1 Struktura sintaksore si shtresë letrare

Siç e dimë, vetë struktura morfologjike e gjuhës shqipe standarde është rezultat i proceseve të hershme historike të strukturës morfologjike të saj. Mund të themi se elementet e saj përbërëse vijnë nga gjuha popullore ose janë risi të integruara prej kohës në gjuhën e shkrimit. Në ditët tona kjo strukturë mund të themi se është e dhe e qëndrueshme. Në shumicën e rasteve norma e sotme morfologjike përbëhet nga forma vetmore, kurse në sistemin foljor ka ushtruar ndikim forma përfaqësuese e foljes (veta e parë njëjës e së tashmes së dëftores) ose forma e vetës së parë njëjës të paradigëmës përkatëse. Norma e sotme e habitores **kënduaka, shkuaka, vrapuaka**, po lëkundet mjaft nga format **këndoka, shkoka, vrapoka**, që gjallojnë në gjuhën e folur të disa trevave dhe po shfaqen edhe në shkrim<sup>8</sup>. Struktura sintaksore për vetë natyrën e saj është e hapur për zhvillime dhe lidhur drejtpërdrejtë me nevojën e shprehjes së asaj, që njeriu arrin në procesin e mendimit e të arsyetimit. Struktura sintaksore zhvillohet e pasurohet duke shprehur hollësitë e mendimit dhe larminë e rapoteve kuptimore<sup>9</sup>. Një bashkëjetesë të përqendruar të dashurisë, vdekjes dhe ëndërrës, pa dyshim që mund ta gjejmë më të theksuar te romani: *Prilli i thyer*.

Po cila është vdekja reale-ajo kur mbylлим sytë apo ka vdekje të tjetra në jetë? Pikërisht përpara kësaj sfide, luhet teatri i Dianës dhe Gjorgut. Një *Prill i thyer* në mes si një dashuri e thyer në mes, sepse prilli është edhe muaji i njohur i dashurisë. Ata të dy nuk kanë nevojë të takohen, të njihen. Ata janë dashuria dhe vdekja e pakapshme, në të njëjtën kohë<sup>10</sup>.

### 2.2 Veçantitë sintaksore përbëjnë vlerë letrare

Gjuha është një mjet universal, me anë të së cilës shprehim atë çka mendojmë apo atë çka ndjejmë. Prandaj mund të themi se sistemi gjuhësor, është shumëplanësh dhe i ndërlikuar vende-vende. Përmes saj, pra gjuhës dhe veçantive që ajo ka përbën në vetëvete një vlerë letrare, gjë të cilën e ka vënë mjaft bukur në dukje shkrimtari Ismail Kadare.

<sup>8</sup> Emil Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, në: "Studime Filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, 12-13.

<sup>9</sup> Mahir Domi, *Procese dhe prirje të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, në: "Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë", Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1988, f. 73-87.

<sup>10</sup> Ismail Kadare, *Vepra-parathënie*, Onufri, Tiranë, 2009, f.12-13.

Për të arritur në këtë rezultat, pra që veçantitë sintaksore të çojnë në përcaktime dhe vlera letrare, duhet të jenë në pajtim të plotë fjalia me periudhën. Midis dy njësive komunikative, *fjalisë* dhe *periudhës*, ka anë të përbashkëta, por edhe dallime. Për shembull, të dyja njësitë kanë të përbashkët funksionin e tyre kumtues a komunikativ, kanë të dyja unitet kuptimor dhe gramatikor si dhe intonacion të përfunduar. Veçse të dyja këto njësi sintaksore dallojnë nga njëra-tjetra si p.sh:

*Së pari*, sepse njësitë kallëzuesore që përbëjnë periudhën, nuk kanë intonacion të përfunduar dhe kuptim të plotë, kurse periudha po.

*E dyta*, mjetet e lidhjes sintaksore të periudhës, janë shumë më të pasura se ato të fjalisë, çka bën që periudha të ketë informacion më të gjerë se fjalia e mundësi shprehjeje më të mëdha.

*Së treti*, elementet përbërëse të periudhës janë të ngjashme me fjalitë e thjeshta,

*E katërta*, fjalitë në periudhë kanë po atë strukturë dhe po atë përbërje leksiko – gramatikore, si fjalitë e pavarura të mëvetësishme.

Dimë gjithashtu se foljet e shqipes i përkasin tipit indoeuropian të foljeve. Gjuha shqipe ka mënyrën habitore, e cila përdoret për të shënuar një veprim ose një fakt, ku folësi flet në mënyrë të papritur dhe që ngjall habi të bashkëbiseduesi. Mënyra habitore gjen përdorim të shpeshtë në tregimet apo në përrallat popullore. Koha e tashme dhe koha e pakryer e saj janë formuar me përngjitje nga një formë analitike e përbërë nga pjesorja e shkurtuar e foljes që zgjedhohet dhe format vetore të së tashmes, gjegjësisht të së pakryerës, të foljes ndihmëse kam, me fjalë të tjera, për nga formimi ajo është një e kryer e përmbysur: *lidhkam-lidhë + kam; lidhke, lidhka etj, punokam ose punuakam-punua + kam, punoke etj, lidhkëshin-lidhë + kishim, lakëshim-la + kishim*<sup>11</sup>.

Në pasqyrat e zgjedhimit të foljeve, për të tashmen dhe të pakryerën e habitores së foljeve me temë më –o(j) dhe –e (j) jepen forma të ndërtuara mbi bazën e temës së të tashmes së këtyre foljeve: *punuakam, punuaka, punuakëshit, punuakan, punuakëshin*, kurse foljet e klasës së dytë temën pëlqye- (pëlqye-r); *pëlqyekam/pëlqyekësha, pëlqyeke, pëlqyekëshe, pëlqyeka/pëlqyekësh, pëlqyekësha, pëlqyeke*.

Duke i dhënë si trajta të vetme normative për këto dy klasa foljesh format me bazë temën e së tashmes, jo vetëm që nuk merren parasysh faktet e derivimit trajtëformues, por përmbysen edhe hierarkia e këtyre varianteve në ligjërim, ku si trajta normative përdoren ato që rrjedhin prej temës

---

<sup>11</sup> Mahir Domi, *Shqipja dhe struktura e saj gramatikore*, në: "Studime Filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2001, f.10-13.

të së kryerës së thjeshtë, që në këto pasqyra as paraqiten fare, kurse format e dhëna në pasqyrat në fjalë hasen shumë rrallë si variante jonormative të të parëve<sup>12</sup>.

Mënyra habitore në romanet e Ismail Kadaresë dallohet për ngjyrim emocional dhe stilistik, ku kjo mënyrë ka fuqi simbolike, duke krijuar kontekste stilistike. Gjatë analizës në romanet e Ismail Kadaresë kjo mënyrë na del me trajta me trajta gramatikore dhe me ngjyresa kuptimore.

Folja e Kadaresë i jep ngjyrë tekstit të tij dhe e bën të veçantë dhe të dallueshëm. Më tej vendosjen kuptimore me vlerë stilistike parakuptohet edhe tejkvendosja kuptimore e kohëve dhe e mënyrave foljore. Format dhe mënyrat e kohëve foljore bashkë me kuptimet e tyre themelore dhe kuptimet e bartuara, në gjuhën e Kadaresë, realizohen në plotësinë e tyre. Të gjitha format e kohëve dhe të mënyrave foljore kanë kuptime gramatikore dhe vlera stilistike.

Mënyra habitore dhe dhe ajo dëshirore janë ndër mënyrat më karakteristike të shqipes shprehet profesor Xhevat Lloshi. Ato japin modalitet të shoqëruar me ndjenjë, prandaj në thelb janë forma shprehëse, prania e tyre sjell vetvetiu ngjyrim në fjalitë e tekstit. Në gjuhën e Kadaresë gjejmë të përdorura këto forma të habitores: *e tashmja, kohët e shkuara, e kryera, më se e kryera* dhe disa *forma të parregullta* që, përgjithësisht i gjejmë në ligjërimin popullor edhe në folklor.

Në gjuhën e Kadaresë gjejmë shembuj të habitores që shprehin dyshim, habi, mosbesim etj. Trajtat e habitës shfaqen me pjesëzat mohuese *nuk* ose *s'*, ku jepet jo vetëm koha e caktuar në vepër, forma veprare ose joveprare, por edhe modaliteti i vërtetësisë ose jo. Kur shoqrohet me pjesëzën e mohimit dhe nuk shpreh vetëm habi, por edhe dyshim për kryerjen e verpimit ose jo. Për efekt stilistik Kadare sjell shpeshherë pranë e pranë dy kohë të ndryshme të habitores. Shqipja është një gjuhë me një sistem shumë të pasur formash për shprehjen e raporteve kohore. Folësit e gjuhës, mund të përdorin shpesh një formë për tjetrën për të shprehur kuptime të ndryshme nga ato që janë tipike për atë formë. Në literaturën tonë gjuhësore kuptimet e kohëve të foljes janë studiuar në mënyrë të pamjaftueshme. E meta themelore në këtë pikë neve na duket se është studimi dhe analiza e tyre në mënyrë të shkëputur<sup>13</sup>.

Në sistemin foljor të shqipes, siç dihet, ka një pasuri të madhe formash, nëpërmjet të cilave shprehen kuptime të ndryshme gramatikore. Një rol të rëndësishëm në këtë sistem luajnë pa dyshim kategoritë gramatikore të mënyrës dhe të kohës, të cilat paraqiten me një larmi realisht të madhe formash dhe kuptimesh gramatikore.

---

<sup>12</sup> Rami Memushaj, *Çështje të normës morfologjike në fjalorët shpjegues të shqipes*, në: "Studime Filologjike", nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2007, f. 46.

<sup>13</sup> Fatmir Agalliu, *Vëshgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, në: "Studime Filologjike", nr. 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1968, f. 120.

Këto dy kategori gramatikore në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhë të tjera indoevropiane, janë të lidhura ngusht midis tyre. Siç do të shtjellohet më tej numri i formave kohore të një mënyre është i kushtëzuar nga lloji i modalitetit. Gjithashtu në mjaft raste treguesi gramatikor i kohës është njëherazi edhe rast që si tregues gramatikor i mënyrës shërben një formant i posaçëm. Kështu p.sh., tek format foljore të mënyrës dëftore treguesit gramatikorë të kohës janë njëherazi edhe treguesit e kategorisë së mënyrës.

Anasjelltas, tek format foljore të dëshirores dhe të habitores treguesit gramatikorë të mënyrës janë njëherazi edhe treguesit e kategorisë së kohës. Por tek format e lidhore janë njëherazi edhe treguesit e kategorisë së mënyrës.

Por lidhja midis kategorisë gramatikore të mënyrës dhe asaj të kohës nuk e përshkon të tërë paradigmen e foljes. Kur modaliteti i një mënyre nuk ka lejuar të krijohen forma foljore, që t'i kundërvihen njëra-tjetrës në planin kohor<sup>14</sup>.

Për gjuhën shqipe pranohen zakonisht gjashtë mënyra: **dëftorja, habitorja, lidhorja,, kushtorja, dëshirorja dhe urdhërorja**. Në tërë traditën e mëparshme gramatikore pranoheshin si mënyra të foljes edhe pjesorja, paskaroja dhe përcjellorja, por gjuhësia shqiptare ka mbajtur një qëndrim kritik ndaj këtij trajnimi, duke qenë se nëpërmjet formave të pashtjellura të foljes nuk shprehet qëndrimi i folësit lidhur me veprimin e emërtuar nga folja, duke e paraqitur këtë si të vërtetë, të mundshëm, të dëshirueshëm, të domosdoshëm. Gjithashtu në disa gramatika të shqipes flitet edhe për një mënyre lidhore-habitore (**të paskështa, të paskështa pasur**)<sup>15</sup>.

Për mënyrën habitore dhe kushtore gjuhëtarët shqiptarë dhe të huaj kanë mbajtur qëndrime të kundërta. Një palë i kanë pranuar ato si mënyra më vete, kurse një palë tjetër i kanë trajtuar si forma të mënyrës dëftore.

Çështja nëse habitorja dhe kushtorja janë mënyra më vete apo janë forma foljore të mënyrës dëftore të pajisura edhe me disa nuanca modale të caktura, është një çështje me interes jo vetëm teorik, por edhe praktik. Nga pikëpamja teorike duhet sqaruar nëse ato si për nga tipi i ndërtimit, ashtu edhe për nga kuptimet modale dallohen nga format foljore të dëftores.

Nuk është pa interes të vështrohet çështja edhe nga ana praktike, d.m.th, a është më praktike që ato të veçohen nga mënyra dëftore, apo të përfshihen në këtë mënyrë. Për sa i përket anës praktike,

---

<sup>14</sup> Shaban Demiraj, *Rreth kategorisë gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, në: "Studime Filologjike", nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1977, f. 101.

<sup>15</sup> Po aty, f. 102.

duhet marrë në vështrim edhe denduria e përdorimit të formave në shqyrtim me këtë apo atë kuptim modal<sup>16</sup>.

Për sa i takon formave sintetike të habitores, e tashmja (**punuakam**) dhe e pakryera (**punuakësha**) për nga tipi i ndërtimit dallohen shkoqur nga format përgjegjëse të së tashmes (**punoj**) dhe të së pakryerës (**punoja**) të mënyrës dëftore.

Edhe format analitike të së kryerës (**paskam punuar**) dhe të më se të kryerës (**paskësha punuar**) të mënyrës habitore dallohen qartë nga format përgjegjëse të mënyrës **dëftore (kam punuar, kisha punuar)** nëpërmjet formave përkatëse të foljes ndihmëse (**paskam, paskësha përkundrejtë kam, kisha**). Edhe për nga kuptimi modal format kohore të habitores dallohen nga format përgjegjëse të dëftores<sup>17</sup>.

Megjithëse si forma të habitores dallohen nga format përgjegjëse të dëftores, si format kohore të dëftores edhe ato të habitores, rregullisht shprehin kuptimin modal të vërtetësisë, të dytat dallohen nga të parat, sepse nëpërmjet tyre folësi shpreh edhe ndjenjën e habisë, me anën e së cilës ai shpreh ndonjëherë edhe një qëndrim ironizues, mosmiratues.

Pra, ndërsa format kohore të dëftore për nga modaliteti karakterizohen negativisht, format kohore të habitores për nga modaliteti karakterizohen pozitivisht. Dhe në të vërtetë, format kohore të habitores përdoren jo aq shumë për të pohuar kryerjen e një veprimi se sa për të shprehur habinë e folësit në çastin e ligjërit të tij për veprime, që po kryhen në atë çast ose që janë kryer para atij çasti<sup>18</sup>.

Veçimi i habitores si një mënyrë më vete mund të vihej në dyshim, në rast se format habitore me kuptimet modale përkatëse do ishin krijuar e mbajtur në përdorim edhe tek mënyrat e tjera, d.mth, në rast se edhe mënyrat e tjera krahas formave të tyre kohore të zakonshme do të kishin në përdorim edhe forma dytësore, që do të shërbenin për të shprehur krahas modalitetit themelor përkatës edhe ndjenjën e habisë së folësit.

Në këtë rast tek çdo mënyrë do të flitej për një paradigmë dyshe me forma kohore të zakonshme dhe me forma kohore habitore, por një dukuri e tillë në gjuhën e sotme shqipe nuk ndodh. Për gjithë këto arsye, veçimi i formave kohore të habitores në një mënyrë më vete është plotësisht i përligjur.

---

<sup>16</sup> Shaban Demiraj, *Rreth kategorisë gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, vep e cit., 1977, f. 103.

<sup>17</sup> Po aty, f. 104-105.

<sup>18</sup> Po aty, f. 104.

Po aq i përligjur është edhe mospranimi i së ashtuquajturës mënyrë lidhore-habitore, duke i ruajtur format e tipit **të paskësja** dhe **paskësja pasur** si forma dytësore joletrare dhe të rralla të së pakryerës, përkatësisht të më se të kryerës së mënyrës lidhore<sup>19</sup>.

Koha e ardhme ndërtohet në mënyrë analitike, me dy forma: **me do (forma e foljes dua) + lidhore (do të punoj)** dhe me foljen ndihmëse **kam + paskajore (kam për të punuar)**. Rendi i fjalëve në fjali është përgjithësisht i lirë, por më i zakonshëm është **rendi kryefjalë+folje+objekt**.

Rastet ku hasim fjalën-foljen **habi** e hasim në këto forma gjatë analizës së romaneve si në rastet e poshtëcituar:

**Rasti I:** Romani: *Gjerenali i ushtrisë së vdekur: **Habi**, gjest **habie**, u **habit**, ne u **habitëm**, do të jenë **habitur**, nga **habia**, një gjest **habie**, thirri e **habitur**, një britmë **habie**, thirri i **habitur**, të **habitura**, me fytyrë të **habitur**, të **habitur**, nguli sytë i **habitur**.*

**Rasti II:** Romani: *Çështje të marrëzisë: S'thirra nga **habia**, me sytë e shqyer nga **habia**, ishte e **habitshme**, madje **habia** po më përzihej, pyetje e **habitshme**, s'pushoja së **habituri**, vështruar me **habi** njerëzit, nuk kisha më fuqi as të **habitesha**.*

**Rasti III:** Romani: *Prilli i thyer: Gati i **habitur**, shikoi i **habitur**, **habitshëm**, pak **habitshëm**, kishin vështrimin **aq habitshëm**, sikur e ndjeu **habinë** e tij, mos u **habit** aspak, do të ishte e **habitshme**, e ka krijuar këtë **habi**, ajo **habitej** se si e kuptonte, duke u **habitur**.*

Fjalën **dyshim-e papritur** që shpreh mënyrën habitore e hasim në këto forma gjatë analizës së romaneve si në rastet e poshtëcituar:

**Rasti I:** Romani: *Gjerenali i ushtrisë së vdekur: **papritur** e ndjeu veten, zhvillohet **papritur**, tani, **papritur**, pastaj, **papritur**, pyeti **papritur**, u kthye **papritur**, kur shfryhet **papritur**, zgjidhën këmbët **papritur**, **papritur** qava, **papritur**, thirrje e tillë, gjeneralin i bë **papritur** arrogant, britmë **habie**, Tha **papritur**, të ikim, tha **papritur**, **dyshoj** se është infektuar, as që e ve në **dyshim**.*

**Rasti II:** Romani: *Çështje të marrëzisë: Nga zhvendosjet e **papritura** të lexuesit, dhe një hije **dyshimi**, **dyshova** se i kishte ndërruar, ngaqë **dyshohej** që teza e vogël, **dyshohej** se ishin marrë vesh të dy, erdhi **papritur** të hënën, të **papriturën** tronditëse, tani s'kisha asnjë **dyshim**, pa **dyshim**, kisha **dyshuar**.*

---

<sup>19</sup> Shaban Demiraj, *Rreth kategorisë gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, vep e cit., f. 104.

Habitorja është edhe mënyra më e mirë për të shprehur ndjenja përbuzëse a përçmuese, ajo gjithashtu është një mënyrë shumë e përshtatshme për të ironizuar.

Trajtat morfologjike të mënyrës në gjuhën shqipe shprehin realitetin e procesit ose jorealitetin e tij. Kështu, mënyra dëftore e tregon procesin si diçka reale; habitorja zakonisht si diçka reale që shkakton habi, si diçka të papritur etj.

**Rasti I: romani Gjenerali i ushtrisë së vdekur<sup>20</sup>:**

*Pastaj, papritur, tha me vete: Ç'të ketë bërë vallë me gruan e ve të kolonelit? Ç'të ketë vallë midis tyre?*

**Rasti II: romani Çështje të marrëzisë<sup>21</sup>:**

*Ungji i madh, që për çudi, Ah, ç'na the!-tha tezja e vogël. Ashtu qenkam unë për ty, një tyryfyle?.*

**Rasti III: romani Prilli i thyer<sup>22</sup>:**

*...por tjetri u duk sikur u ndjeu habinë e tij. Pse çuditësh? Ka njerëz që presin qysh dje. Ashtu?*

Fjalja është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht, të shqiptuara me një intonacion mbarimi, dhe që shpreh një gjykim, një pyetje, një dëshirë, habi, një nxitje a një ndjenjë habie, si dhe qëndrimin e folësit ndaj realitetit të brendisë së kumtimit<sup>23</sup>.

Fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme që tregojnë vlerësim emocional të kumtimit, shprehin gëzim, kënaqësi, hidhërim, pikëllim, keqardhje, habi, inat, zemërim, revoltë. Të tilla janë fjalët e togje si: **fatmirësisht, lumturisht, mjerisht, çuditërisht, çudi, si për çudi, për djall, për mrekulli, për habi, për bela, për sherrin tënd.**

Togjet për **çudi**, për **habi** mund të zgjerohen me një emër ose përemër, që tregon personin që çuditet për faktin e kumtuar. Si në rastet në romanet përkatëse të Kadaresë si:

**Rasti I: romani Gjenerali i ushtrisë së vdekur:**

*U habit, çuditë, e çuditshme, të çuditur, me habi, një gjest habie etj, si në rastet e cituara më poshtë nga vetë romani:*

---

<sup>20</sup> Ismail Kadare, romani *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, f. 20.

<sup>21</sup> Ismail Kadare, romani *Çështje të marrëzisë*, f. 37-38.

<sup>22</sup> Ismail Kadare, romani *Prilli i thyer*, f. 74.

<sup>23</sup> Gramatika e gjuhës shqipe 2, vep e cit., f. 111-112



-Një gjë ishte e **çuditshme**, (Gj.U.V:25).

-Pak **të çuditur**, (Gj.U.V:41).

-Pa **me habi** veturën, (Gj.U.V:44).

-**Papritur** pa diçka **të çuditshme**, (Gj.U.V:47).

-Bëri një **gjest habie**, (Gj.U.V:47).

-**S'është çudi**, (Gj.U.V:48).

-Gjenerali **u habit** fare, (Gj.U.V:51).

-Me ca telegrame **të çuditshme** në duar, (Gj.U.V:53).

-**Po çuditem**, -tha gjenerali, (Gj.U.V:53).

-Mbase u vinte **çudi** se si u gjendën ashtu **papritur** në këtë qytet **të çuditshëm** të gurtë, (Gj.U.V:59).

-Ato do të jenë **habitur** dhe do të kenë thënë midis tyre se ç'popull **i çuditshëm**, (Gj.U.V:60).

-Vështronin **me çudi e duke qeshur**, (Gj.U.V:61).

-Njeriu **më i çuditshëm** në gjithë këtë plazh, (Gj.U.V:73).

-Shqyen sytë nga **habia**, (Gj.U.V:83).

-Pyeti **papritur**, (Gj.U.V:85).

-**Po çuditem** me vete, (Gj.U.V:89).

-Tregojnë gjëra **të çuditshme**, (Gj.U.V:96).

-Dhe të vjen **çudi**, (Gj.U.V:100).

-Diçka e fshehtë, **e çuditshme**, (Gj.U.V:106).

-**Çudi**, (Gj.U.V:111).

-Fenomen **i çuditshëm**.. Me të vërtetë **i çuditshëm**, (Gj.U.V:114).

-Bëri një **gjest çudie**, (Gj.U.V:137).

-Kjo **po më habit**, (Gj.U.V:138).

-**Çudi**-tha prifti, Gj.U.V:143).

-Me fytyrë **të habitur**, (Gj.U.V:179).

-Lëshonin hije **të çuditshme**, (Gj.U.V:217).

-I nguli sytë **i habitur**, (Gj.U.V:230).

#### **Rasti II: romani Çështje të marrëzisë:**

- *Gati sa s'thirra nga habia*, (Ç.M:3).
- *Ajo më vështroi me sytë e shqyer nga habia*, (Ç.M:4).
- *Shyqen sytë nga habia*. (Ç.M:11).

- *Madje **habia**, (Ç.M:14).*
- *S'pushoja **së habituri**, (Ç.M:25).*
- *Që **për çudi**, (Ç.M:37).*
- ***Për çudi**, i ishte shtuar, (Ç.M: 40).*
- ***Për çudi**, nuk tha asgjë, (Ç.M:48).*
- *Duke vështuar **me habi** njerëzit, të cilët, po **aq habitshëm**, i ndiqnin me sy, (Ç.M:56-57).*
- *Gojëhapur po i dëgjoja, ndërsa e ndieja se nuk kisha më fuqi as **të habitesha**. (Ç.M:90).*

**Rasti III: romani Prilli i thyer:**

- *Dhe **gati i habitur** po shikonte se ç'po ndodhte, P.Th:26-27).*
- *Gjorgu i shikoi **i habitur** duart, (P.Th:27).*
- *I ati e vështroi **pak habitshëm**, (P.Th:38).*
- *U duk sikur e ndjeu **habinë** e tij, (P.Th:74).*
- *Pse **çuditësh?**, (P.Th:74).*
- *Po ti mos **u habit** aspak, (P.Th:81).*
- *Dhe tani vjen pyetja: përse shqiptari e ka krijuar këtë **habi?**, (P.Th:100).*
- *Diana po e shikonte **me habi**, (P.Th:112).*
- *Besiani vështroi një grimë **me habi** të shoqen, (P.Th:129).*
- ***E habitur** dhe vetë për fjalët e saj, (P.Th:135).*
- ***Të habitur**, ata shikonin shokun e tyre, (P.Th:147).*
- *Kurse mbrëmë, **për habinë** e të gjithëve, ai e kishte shkelur zakonin, (P.Th:151).*
- *Madje, **u habit** pak, kur njohu rrethinat e fshatit, (P.Th:171).*
- *Ujëbardha e Epërme është këtu afër? –pyeti Besiani, **i habitur**, (P.Th:196).*
- *Besian Vorpsi e vështroi një copë herë **me habi** bashkëfolësin, (P.Th:204).*

Nga shembujt e analizuar na del mënyra habitore herë na del e vërtetë, herë si e sigurt, herë e domosdoshme dhe herë e dyshimtë, ku vetë folësi shpreh sigurinë e tij, kurse në rastet kur fjalitë kushtore na dalin me lidhëzën sikur, shprehin në mënyrë më të theksuar karakterin supozues apo atë të kushtit.

### KREU III: Mënyra habitore në shtrirje letrare

#### 3.1 Mënyra habitore në veprën artistike të Ismail Kadaresë

Për të folur për mënyrën habitore dhe mënyrën sesi është zhvilluar ajo, fillimisht e kemi parë të arsyeshme që të ndalem në kohët e foljes që ofron gjuha shqipe, duke parë sesi ndodh zgjedhimi në këto kohë në mënyrë të përgjithshme dhe pastaj duke u ndalur gjatë të mënyra habitore e gjuhës shqipe.

Foljet në mënyrën habitore shprehin ndjenjën e habitës për një veprim të papritur që është kryer në të shkuarën ose që kryhet në çastin kur flasim<sup>24</sup>.

Shembulli i parë: Romani, “Çështje të marrëzisë”: *Në fund të fundit, Kadare mendon se bota jonë është një botë të marrësh.* (Ç.M.xi). **Mënyra dëftore.**

Shembulli i parë: Romani, “Çështje të marrëzisë”: *Por kjo e vërtetë e thjeshtë nuk mund të zbulohet me asnjë nga instrumentet e njohjes që ka shpikur njerëzimi, me asnjë nga teoritë, ideologjitë, apo kuturisjet e marra nëpër botë.* (Ç.M.xii). **Mënyra lidhore.**

Shembulli i dytë: Romani, “Çështje të marrëzisë”: *Të jesh lexues i një shkrimtari do të thotë të pjesëmarrësh në aventurën e tij, të kalosh nëpër të gjitha rreziqet që kalon ai, të ndash me të të gjitha pasojat që sjell kuturisja nëpër botë.* (Ç.M.x) **Mënyra lidhore.**

Shembulli i parë: Romani, “Çështje të marrëzisë”: *Ajo vazhdoi të fliste gjithë pezëm dhe pas çdo fraze thoshte prapë “more vesh”? dhe kushedi ku do të mbërrinte me gjithë atë pezëm, sikur, befas, të mos i ndërronte mendja.* (Ç.M:5). **Mënyra kushtore.**

Shembulli i parë: Romani, “Çështje të marrëzisë”: *Gjatë kohës që tezja fliste, mua më kishte shkuar mendja në gjithfarë letrash, shumica kërcenuese, si ato të piratëve, me vrime në mes, ose pusulla të Makbethit, që ia dërgonte vrasësit të dytë a të tretë, për të hequr qafe dikënd, kurse ajo paskësh qenë njëfare dëftese e rëndomtë.* (Ç.M:19). **Mënyra habitore.**

Shembulli i dytë: Romani, “Çështje të marrëzisë”: *Befasime të tjera rrokulliseshin si rrungajë gjatë gjithë pasdites. Bashkë me zyrat po shpallehin edhe anëtarët e partisë komuniste. Po dilte se*

---

<sup>24</sup> Bahri Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe*, EDFA, Tiranë, 2004, f. 113.

**qenkëshin** të tillë ca që s'pritej kurrsesi e, nuk **qenkëshin** ca të tjerë që, jo vetëm ata vetë, por gjithë bota i dinte për komunistë e kaluar komunistëve. (Ç.M:55). **Mënyra habitore.**

Shembulli i parë: Romani, "Çështje të marrëzisë": **Ngrehu**, themeluesi i shtetit, thirra me vete. **Ndize** llullën e luftës! **Bjeri** Greqisë, siç e ke patur zakon. **Bjeri**, pas saj, shteteve të tjerë, si të të shkrepet, Maqedonisë, Malit të Zi, kush të të dalë përpara! **Bëje** tym e flakë! (Ç.M: 75). **Mënyra urdhërore.**

**Shembulli i dytë:** Romani, "Çështje të marrëzisë": **Ngrihuni**, o gra, kishte thirrur, **bëmani** gati stromën prej kashte dhe bucelën e ujit se do futem në hapsanë. (Ç.M:11). **Mënyra urdhërore.**

**Shembulli i tretë:** Romani, "Çështje të marrëzisë": **Tani dëgjo**, tha. S'ishte letër dashurie ajo që pashë. **Tani dëgjo**, tha prapë ajo. Nuk kam të lehtë të ta shpjegoj. Ti e di, ke dëgjuar, besoj, kaq herë të flitet për atë që quhet parti komuniste. **Dëgjo**, tha tezja për herë të tretë, dhe mos më ndërprit. (Ç.M:18-19). **Mënyra urdhërore.**

**Shembulli i katërt:** Romani, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur": Oh, punë të rëndë ka, por ai di ta bëjë. Jo më kot dërguan atë. Zoti e **ndihmoftë!** **Mënyra dëshirore.**

**Shembulli i pestë:** Romani, "Prilli i thyer": Kishim një mësues gjeografie që përsëriste shpesh: **mos vdeksha** pa e parë Ujëbardhën e Epërme. **Mënyra dëshirore.**

### 3.2 Përdorimi i mënyrës habitore në tri romanet e Ismail Kadaresë

*Koha e tashme e mënyrës habitore:*

E tashmja e habitores formohet duke i prapangjitur pjesores së shkutër të foljes format vetore të së tashmes së foljes ndihmëse kam.

*Ja, pra, këta qenkan shqiptarët!-tha gjenerali sikur të vazhdonte një bisedë të lënë përgjysmë.* (Gj.U.V. 31).

*Ju flisni shpesh për grekët dhe trojanët. Përse nuk u dashka të flasim për njëzet vjet më parë.* (Gj.U.V. 54).

*Koha e pakryer:*

E pakryera e habitores formohet duke i prapangjitur pjesores së shkutër të foljes format vetore të së pakryerës së ndihmëses kam. Këto të fundit, duke qenë të patheksuara, kanë pësuar disa ndryshime fonetike.

*Koha e kryer:*

E kryera është një nga format kohore të habitores e cila përdoret më shumë, sepse ndjenja e habitës është pasojë e veprimeve të përfunduara<sup>25</sup>.

*E kryera e habitores e shqipes:*

E kryera ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljeve format vetore të kohës së tashme habitore të ndihmëses kam: paskam (paske, paska, paskemi, paskeni, paskam).

*Porsa ka marrë vesh që erdhëm ne, **paska vënë** medaljet, **paska ndeshur** kuburën dhe ka dalë përjashta. (Gj.U.V. 168).*

*Në qoftë se ai është varri i parë, siç dyshohej, atëherë mund të thuhet se është ky rrezikzi, që e **paska hequr** këmbën zvarrë, siç thonë pleqtë e këtushëm. (Gj.U.V. 152).*

*Koha më se e kryer:*

Më se e kryera ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së pakryerës habitore të ndihmëses kam: paskështa (paskështe, paskësh, paskëshin, paskëshit, paskëshin).

*Ndryshe nga ç'i qe dukur në fillim: e fisme, lehtësisht e gërmueshme, dëbora **paskësh qenë** po aq e mbrapshtë sa edhe balta (Gj.U.V. 186).*

*Sipas kësaj logjike dikush tha se **qenkëshim** mërziur kot gjer tani dhe **s'paskësh qenë** fjala për hapjen e shtëpisë publike, por të frontit të dytë (Gj.U.V. 70).*

*Në fjali të pavarura si në këtë rast: Dhe ja, e papritura i **paskësh ndodhur** kolegut të tij (Gj.U.V. 235).*

---

<sup>25</sup> Et'hem Lika, *Format analitike në gjuhën shqipe*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2000, f. 111.

#### KREU IV: Analizë e mënyrës habitore në romanet e Ismail Kadaresë

Çdo ditë njerëzit marrin e japin informacione për nevojat e jetës së përditshme ose për probleme të tjera. Të gjithë njerëzit kanë aftësinë për t'i komunikuar njëri-tjetrit mendimet e tyre, për të shprehur ndjenjat, dëshirat ose kërkesat e tyre me anë të gjuhës. Vetëm njerëzit kanë aftësi të përçojnë sinjale tingëllore ose, siç thuhet ndryshe, shenja gjuhësore<sup>26</sup>. Kjo aftësi është të folurit, por njerëzit kanë edhe një mënyrë tjetër komunikimi me anë të të shkruarit. Këtë gjë më së miri e realizon Ismail Kadare, në romanet e tij, duke përdorur në të shumtën e rasteve mënyrën habitore. Mënyra sesi kjo mënyrë del në romanet e Ismail Kadaresë do e japim më poshtë përmes analizës që kemi gjetur në romanet që kemi marrë në shqyrtim:

##### Rasti I: romani *Çështje të marrëzisë*

1. **Pasi e ka krijuar botën dhe rrëfimin për të, *pasi e ka krijuar mitin e saj, autori me këtë roman i përkushtohet zhbërjes së botës, ç'mitizimit të saj. Ndryshe na *qenka* bota. Ndryshe nga ç'e *paskemi menduar*. (Ç.M:xiii).***

**Qenka**- mënyra habitore, koha e tashme, veta e tretë njëjës, forma joveprore, rendi i fjalive i përmbysur.

**Paskemi menduar**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e parë shumës, forma veprare, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i përmbysur.

2. *Kur shtyva portën e oborrit të brendshëm, gati sa s'thirra nga **habia**. Babazoti ishte në këmbë, një gjë fort e rrallë, madje aq e rrallë **saqë** m'u duk si njeri i panjohur. Kur të shkrepet të vrasësh veten, e bën më lehtë kur s'e ke revolen sesa kur e ke. Ah, ja ç'na **qenkësh**, mendova tek ngjisja shkallët. (Ç.M:4).*

**Qenkësh**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e dytë njëjës, forma joveprore, rendi i fjalive i zakonshëm.

3. *Ai bëri **sikur** s'kuptoi dhe unë i thashë prapë të mbante gojën kur fliste për tezen time, sepse, ajo, pavarësisht se ishte e bukur, nuk ishte nga ato zuskat që mund të kujtonte ai. Ilirit i kërcyen xhindet. Po nëna e tij zuskë **ishte**? Dhe më kujtoi ditën kur më kishte treguar mbathjet e saj të mëndafshta. Ato, të pëlqente t'i shikoje, por për njerëzit e tu as gjysmë fjale **s'duroke** dot. (Ç.M:14).*

---

<sup>26</sup> Bahri Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe*, EDFA, Tiranë, 2004, f. 19.

**S'duroke**-mënyra habitore, koha e tashme, veta e dytë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i përmbysur.

4. *Por atë, cingërisja e nervave më ndihmoi t'ia them pa asnjë kujdes, atë që mund t'ia kisha sjellë pak më rrotull. Unë e di çfarë i ke parë atë ditë vëllait tënd. **Ah, ashtu?** Ia bëri ajo, pa e ndërprerë krehjen. Meqë e **ditke**, pa ma thuaj. (Ç.M:16).*

**Ditke**-mënyra habitore, koha e tashme, veta e dytë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i tretë, rendi i fjalive i zakonshëm.

5. *Mendja më ishte bërë lëmsh. Për këtë **dashkësh** të vriste veten ungji i vogël? Gjatë kohës që tezja fliste, mua më kishte shkruar mendja në gjithfarë letrash, shumica kërcenuese, si ato të piratëve, me vrimë në mes, ose pusulla të Makbethit, që ia dërgonte vrasësit të dytë a të tretë, për të hequr qafe dikënd, kurse ajo **paskësh qenë** njëfarë dëftese e rëndomtë. (Ç.M:19).*

**Dashkësh**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i tretë, rendi i fjalive i përmbysur.

**Paskësh qenë**- mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

6. *Iliri ia bëri prapë pu-pu, pastaj bëri një nga ato pyetjet që të prishin gjakun: kur **qenkësh** kaq e fuqishme përse fshihej? (Ç.M:20).*

**Qenkësh**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e dytë njëjës, forma joveprorë, rendi i fjalive normal.

7. *E dinin të gjithë në familje se, nga zbulimi i së vërtetës, i asaj të vërtetë të dhimbshme se ungji i vogël **paskësh qenë komunist**, ndërsa i madhi, ai që i kishte folur së pari për komunizimin, nuk ishte, e kishte plagosur thellë në sedër këtë të fundit. (Ç.M:32-33).*

**Paskësh qenë**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

8. *Se **ç'paskësh qenë** kjo vetëtimë, ku e kishin gjetur nëpër qiej e si e **paskëshin** sjellë gjer në Gjirokastër, për t'u kacafytur për të, këtë një zot e dinte. (Ç.M:34-35).*

**Ç'paskësh qenë**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i normale.

**Paskëshin**- mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë shumës, forma veprorë, rendi i fjalive i normale.

9. *Njerëzit gati sa s'po u besonin syve. Kishin kujtuar se zyrat e partisë qenë të fshehura thellë, së paku në katakombet e kështjellës së vjetër, për të mos thënë në malet e pakalueshme, atje*

ku kishin qenë gjatë luftës, siç e thoshte dhe kënga: Policani grykë e keqe, vend i zyrave sekrete". Mirëpo ato **paskëshin qenë** mu aty, në hunbë të tyre, e mendja s'i kishte shkuar askujt. (Ç.M:55).

**Paskëshin qenë**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë shumës, forma veprare, rendi i fjalive i zakonshëm.

10. Por kjo nuk ishte veçse fillimi i **habisë**. Befasime të tjera rrokulliseshin si rrungajë gjatë gjithë pasditës. Bashkë me zyrat po shpalleshin edhe anëtarët e partisë komuniste. Po dilte se **qenkëshin** të tillë ca që s'pritej kurrsesi e, nuk **qenkëshin** ca të tjerë që, jo vetëm ata vetë, por gjithë bota i dinte për komunistë e kaluar komunistëve. (Ç.M:55).

**Qenkëshin**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë shumës, forma joveprare, rendi i fjalive i zakonshëm.

11. Kështu, një zonjë spitullane, nga ato me kapele e me vel nga të kohës së mbretërisë, që çdo prag spastrimi pertej të internohej si ish-borgjeze, doli anëtare e partisë, në kohën që egërshani Haxhi Fterra, ai që me britmat e tij i kallte datën Palortosë së sipërme e të poshtme, nuk **qenkësh kurrkund**. (Ç.M:56).

**Qenkësh**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e dytë njëjës, forma joveprare, rendi i fjalive normale.

12. Njerëzit tek i shihnin tundnin kryet mendueshëm. Gjersa ata ishin shfaqur, kjo do të thoshte se ngjarja që porsa kishte ndodhur, dalja nga mjegulla e komunisteve, **paskësh qenë** tepër e rëndësishme. (Ç.M:57).

**Paskësh qenë**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprare, rendi i fjalive i përmbysur.

13. Befas, si të ishin zgjuar nga gjumi, njerëzit u kujtuan se kjo Madama, që kushëkush e dinte franceze ose kanadeze, pra kjo Madama **s'qenkësh** tjetërkush veçse Makbule Shtinua, nga lagjia Hazmurat. (Ç.M:69).

**S'qenkësh**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e dytë njëjës, forma joveprare, rendi i fjalive i përmbysur.

14. Merhumi i **paska mësuar** turqisht apo më bënë veshët? Thoshte njëra nga gratë. Ashtu m'u duk edhe mua, përgjigj tjetra. Turqishtja është ç'është, po ajo puna e duhanit më la pa mend, thoshte ajo me sy prej qelqi. E **paska helmuar** të voglin që kërthi. (Ç.M:86).

**Paska mësuar**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprare, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i përmbysur.

**Paska helmuar**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprare, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i përmbysur.



15. Nuk **paskëshin qenë** katër gratë vajtores, siç kisha kujtuar, por ai, vëllai misterioz i babazotit, që ishte pritur me ankth. (Ç.M:89).

**Paskëshin qenë**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë shumës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

16. Ky na **paskësh qenë**, me sa dukej, amaneti i fundit i babazotit. (Ç.M:91).

**Paskësh qenë**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e dytë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

17. Kush tha se ai **paska ardhur**?-tha, pa fshehur habinë. (Ç.M:93).

**Paska ardhur**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i tretë, rendi i fjalive i përmbysur.

18. Si mund ta dinte ai që unë isha vrasësi i fshehtë i babazotit? Dhe qa më tepër, si e **paskësh zbuluar** këtë nga shkronjat e hungarishtes? (Ç.M:94).

**Paskësh zbuluar**- mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i përmbysur.

## Rasti II:romani *Prilli i thyer*

1. O, po atëherë **qenka** pikërisht punë kufijsh, gjersa **paska ardhur** ky, gjeometri, siç i thua ti. (P.Th:57).

**Qenka**- mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma joveprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

**Paska ardhur**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i tretë, rendi i fjalive i përmbysur.

2. Pushkë të bukur **paska qitë**, thoshin pleqtë, kur dikush e godiste armikun ballë për ballë dhe në kokë. Ose, **pushkë** të **pabukur**, kur plumbi shponte likthin ose këllqet, për të mos përmendur shpinën. (P.Th:63).

**Paska qitë**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i dytë, rendi i fjalive i përmbysur.

3. Ti **s'pasje qenë** dhe aq larg, i tha njeriu përbri. Mua m'u desh të bëja dy ditë rrugë pa pushim. (P.Th:73).

**S'pasje qenë**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e dytë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

4. **S'dashka** të dalë ky dimër. (P.Th:75).

**S'dashka**-mënyra habitore, koha e pakryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i tretë, rendi i fjalive i përmbysur.

5. **O, po**, atëherë **qenka** pikërisht punë kufijsh, gjersa **paska ardhur** ky, gjeometri, siç thua ti. (P.Th:57).

**Qenka**- mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma joveprore, rendi i fjalive i përmbysur.

**Paska ardhur**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi tretë, rendi i fjalive i përmbysur.

6. Vëre qehajanë e gjakut me shkollë, **meqenëse të paska** ënda shkollën e madhe dhe pastaj, kur qehajajushka të të çmendet që javën e tretë, do ta kujtosh Mark Ukaçjerrën Hm. (P.Th:166).

**Meqenëse të paska**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e parë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

7. **Qenkan zgjuar** bujtësit, mendoj. (P.Th:170).

**Qenkan zgjuar**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë shumës, forma joveprore, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i përmbysur.

8. Pllangat e borës **qenkan shkrirë**, tha me vete. (P.Th:171).

**Qenkan shkrirë**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë shumës, forma joveprore, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i i përmbysur.

9. **Paskam pasur** vërtet fat, mendoj Besiani. (P.Th:193).

**Paskam pasur**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e parë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

10. Si i dehur, ai e vuri enën në gjirmë, pastaj u kujtua për diçka, përkuli kryet te vatra për të parë në brendësi, e bëri këtë dy-tri herë duke u mbrojtur me shputat e duarve nga shkëndijat, gjersa e gjeti, siç duket, atë që kërkonte, sepse thirri: Ja ku **qenka**. (P.Th:195).

**Qenka**-mënyra habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës, forma joveprore, rendi i fjalive i përmbysur.

11. Familja e vajzës, e trullosur nga fatkeqësia, ka të drejtë të tërbohet nga mendimi se nuk i **mjaftoka** humbja e çikës, por i **paskësh** një gjak hua palës kundërshtare, pinjolli i së cilës ishte bërë shkaktar për vdekjen e vajzës. (P.Th:202).

**Mjaftoka**-mënyra habitore, koha e tashme, veta e tretë njëjës, forma veprorë, zgjedhimi i parë, rendi i fjalive i përmbysur.

**Paskësh**-mënyra habitore, koha më se e kryer, veta e dytë njëjës, forma veprorë, rendi i fjalive i përmbysur.

## PËRFUNDIME

Ky studim u realizua falë mbështetjës dhe konsultimeve të heras pas hershme të mentorës sime Dr. Rovena Vata dhe dëshirës sime po ashtu për të studiuar një shkrimtar si Ismail Kadarenë. Vepra e Kadaresë është një kërkim i vazhdueshëm. Këto kërkime e pasuruan letërsinë shqipe me romanin e tij. Me ardhjen e Kadaresë në letërsinë shqipe erdhi edhe një tip i ri proze, ku elementi narrativ, dhe aq më shumë ai deskriptiv, tërhiqet para forcës sugjestive të fjalës, të detajit, të simbolit dhe të figurës artistike.

Veç të tjerave vepra e Kadaresë është shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore të shqipes së njësuar letrare, e mundësive të saj të pakufizuara shprehëse, e pasurisë, e gjallërisë dhe e forcës së magjishme të fjalës shqipe.

Ajo çka e dallon romanet e Kadaresë është pikërisht përdorimi i shpeshtë i mënyrës habitore, e cila kjo mënyrë së bashku me mënyrën dëftore shpreh modalitetin e vërtetësisë, por me habitoren folësi shpreh edhe ndjenjën e habitës.

Habitorja e shqipes për nga tipi i ndërtimit është e veçantë dhe nuk haset në asnjë gjuhë tjetër indoeuropiane. Trajtat e habitores janë formuar nga pjesorja e shkurtuar dhe folja ndihmëse *kam*, argumentim ky i cili është mbështetur nga shumica e gjuhëtarëve.

Format e tjera të habitores (e pakryera, e kryera, më se e kryera, e kryera e mbipërbërë, më se e kryera e mbipërbërë, e ardhmja, e ardhmja e së shkruarës) janë ndërtuar nën ndikimin analogjik të formave kohore gjegjëse të mënyrës dëftore. Trajtat e habitores janë krijuar gjatë një procesi të gjatë dhe e kanë zanafillën para botimit të veprës së Buzukut. Format e habitores së shqipes kanë disa përkime me mënyrën e ritregimit në bullgarisht e maqedonisht.

Mënyra habitore ka dy kohë kryesore: të tashmen dhe të shkruarën, ku e shkruara ka tri nëndarje: e pakryera, e kryera dhe më se e kryera. Mund të hasen gjithashtu edhe forma të mbipërbëra të së kryerës *paskam pasë larë*, dhe të së ardhmes *do të lakam*.

E tashmja e habitores së shqipes jepet në të shumtën e rasteve me të tashmen e dëftorës së greqishtes, madje nuk shoqërohet as nga ndonjë mjet tjetër gjuhësor, i cili të tregojë modalitetin e habitores së shqipes. Trajta e kohës së kryer e habitores është një trajtë sintetike që formohet nga prapavendosja e formave të dala nga e pakryera e foljes *kam*, të cilat kanë pësuar disa ndryshime fonetike, të pjesorja e shkurtuar e foljes.

E kryera e habitores është një nga format që përdoret më shumë. Ajo formohet nga pjesorja e foljes duke i paravendosur foljet ndihmëse kam dhe jam në të tashmen e habitores.

Koha më se e kryer e habitores është një kohë analitike e cila formohet nga e pakryera e habitores së foljeve ndihmëse kam dhe jam dhe pjesorja e foljes.

Vështrimi morfologjik i mënyrave të foljes në gjuhën shqipe duke e përqendruar studimin në mënyrën habitore më dha shumë mundësi për të parë ndërtimin e kësaj mënyre folje dhe funksionin e saj sintaksor në këto tri romane të Kadaresë si në ***“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”***, ***“Prilli i thyer”***, ***“Çështje të marrëzisë”***.

Gjatë këtij studimi analizova dhe stilin dhe theksin logjik, që kishin fjalitë në këto romane. Duke vështruar të gjitha kategoritë morfologjike, duke i analizuar me shembuj nga vepra e Kadaresë.

Që Ismail Kadare është një shkrimtar më përmasa gjigande, kjo është e padiskutueshme, për vet faktin se argumentet që sollëm në këtë punim provojnë më së miri këtë gjë.

Pasuria dhe vlera gjuhësore e tij qëndron në fakt se ai përdor metoda apo rrugët që ndjek për realizimin e fjalëformimeve janë të shumta dhe që i qëndrojnë besnik parimeve apo rregullave gjuhësore. Pra romani ***“Çështje të marrëzisë”*** shërben mjaft mirë si një vepër e cila mbart një produkt shpirtëror, letrar, gjuhësor, të gjithë botëkuptimit të shkrimtarit. Ky shkrimtar është shembulli ideal për të kuptuar harmoninë që di të ndërtojë Kadareja midis formës dhe përmbajtjes.

## BIBLIOGRAFIA:

Agalliu, Fatmir, *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, në: “Studime Filologjike”, nr. 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1968.

Ajeti, Idriz, *Studime dialektore dhe etimologjike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.

Ajeti, Idriz, *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Akademia e Shkencave e Kosovës, konferenca me temë: “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit”, e mbajtur më 10-11 nëntor, Prishtinë, 2011.

Bahri Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe*, EDFA, Tiranë, 2004, f. 113.

Beci, Bahri, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Libri Shkollor, Prishtinë, 1998.

Beci, Bahri, *Konsiderata të përgjithshme për rolin e shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Akademia e Shkencave e Kosovës, konferenca me temë: “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit”, e mbajtur më 10-11 nëntor, Prishtinë, 2011.

Bokshi, Besim, *Format e futurit të shqipes në raport me ato të gjuhëve ballkanike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Akademia e Shkencave e Kosovës, konferenca me temë: “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit”, e mbajtur më 10-11 nëntor, Prishtinë, 2011.

Bulo, Jorgo, *Kadareja dhe letërsia shqipe*, në: “Studime filologjike”, nr. 1-2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006.

Cipo, Kostaq, *Sintaksa*, Tiranë, 1952.

Cipo, Kristaq, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.

Dado, Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006.

Demiraj, Shaban, *Gramatika e gjuhës shqipe (Fonetika, Morfologjia)*, ETMMK, Prishtinë, 1974.

DEMIRAJ, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1985.

Demiraj, Shaban, *Gramatika Historike*, Rilindja, Prishtinë, 1988.

Demiraj, Shaban, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.

Demiraj, Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2004.

Demiraj, Shaban, *Habitorja dhe mosha e saj*, në: “Studime filologjike”, nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1980.

Demiraj, Shaban, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe (dispenca II)*, Tiranë, 1961.

Demiraj, Shaban, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (I dhe II)*, ETMMK, Prishtinë, 1979.

Demiraj, Shaban, *Rreth kategorisë gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, “Studime Filologjike”, nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1977.

Demiraj, Shaban, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, në: “Studime filologjike”, nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1977.

Domi, Mahir, *Çështje të kulturës së gjuhës në fushën e sintaksës*, në: “Gjuha jonë”, nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1983.

Domi, Mahir, *Çështje të përgjithshme të sintaksës*, në: “Studime filologjike”, nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1980.

Domi, Mahir, *Procese dhe prirje të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme*, në: “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë”, 1984, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1988.

Domi, Mahir, *Shqipja dhe struktura e saj gramatikore*, në: “Studime Filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2001.

Elsie, Robert, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001.

Et'hem, Lika, *Format analitike në gjuhën shqipe*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2000.

Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995.

GRUP autoresh, *Gramatika e Gjuhës Shqipe I*, ASHSH, Tiranë 2002.

Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (Morfologji)*, ETMMK, Prishtinë, 1985.

Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe (Morfologjia I)*, Tiranë, 2002.

- Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi II, Sintaksa, Tiranë, 2002.
- Grup autorësh, *Letërsia bashkëkohore shqiptare*, Për shkollat e mesme të përgjithshme, Libri shkollor, 2002.
- Gjinari, Jorgji & Gjovalin, Shkurtaç, *Dialektologjia shqiptare*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
- Ismaili, Rifat, *Historia e letërsisë shqipe II*, Prishtinë, 2000.
- Kadare, Ismail, *Çështje të marrëzisë*, Onufri, Tiranë, 2005.
- Kadare, Ismail, *Darka e gabuar*, Onufri, Tiranë, 2008.
- Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, roman, Naim Frashëri, Tiranë, 1963.
- Kadare, Ismail, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, tregim botuar në revistën “Nëndori”, nr. 5, maj 1962.
- Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
- Kadare, Ismail, *Vepra-parathënie*, Onufri, Tiranë, 2009.
- Kuçuku, Bashkim, *Kadare në gjuhët e botës*, Onufri, Tiranë, 2000.
- Lafe, Emil, *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*, në: “Studime filologjike”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1975.
- Lafe, Emil, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, në: “Studime Filologjike, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002
- Lloshi, Xhevdet, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999.
- Mansaku, Seit, *Tipologji romani dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Akademia e Shkencave e Kosovës, në: konferencën me temë: “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit”, e mbajtur më 10-11 nëntor, Prishtinë, 2011.
- Memisha, Valter, *Kërkime gjuhësore*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2012.

Memushaj, Rami, *Çështje të normës morfologjike në fjalorët shpjegues të shqipes*, në: “Studime Filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2007.

Riza, Selman, *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë, 1997.

Rudaj, Gani, *Foljet e parregullta supletive dhe josupletive në gjuhën e sotme shqipe*, Prizren, 2000.

Rrota, Justin, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Shkodër, 1942.

Sulejman, Fadil, *Praktikumi i gjuhës së sotme letrare shqipe*, Prishtinë, 1984.

Shala, Kujtim, *Shenjat e tekstit*, Faik Konica, Prishtinë, 1999.

Topalli, Kolec, *Pjesorja e shqipes në vështrimin diakronik*, në: “Studime Filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2009



